

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2020


Tiranë, më 26 Shkurt 2021: Në tremujorin e katërt 2020 janë miratuar gjithsej 306 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 202 leje të miratuara në tremujorin e katërt 2019, duke shënuar një rritje prej 51,5 % (tab.2).

Gjatë vitit 2020, janë miratuar gjithsej 961 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 1.094 leje të miratuara në vitin 2019, duke shënuar një rënie prej 12,2 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e katërt 2020, është 554.325 m², nga 241.708 m² miratuar në tremujorin e katërt 2019, duke shënuar një rritje me rreth 2,3 herë (tab.3). Në tremujorin e katërt 2020, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 28,9 miliardë lekë, nga 11,7 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katërt 2019, duke shënuar një rritje me rreth 2,5 herë (tab.4).

Gjatë vitit 2020, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është 1.608.211 m², nga 2.021.749 m² miratuar në vitin 2019, duke shënuar një rënie prej 20,5 %. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 76,6 miliardë lekë në vitin 2020, nga 80,8 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2019, duke shënuar një rënie prej 5,2 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2020 (%)



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 - 2020

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			20.936.982	7.931.355
I. Ndërtesa	306	554.325	18.876.386	1.160.139
1.Ndërtime për banim (rezidente)	230	448.877	14.546.657	458.987
a. Me një kat	75	19.968	671.803	151.355
b. Me dy kate	98	42.060	1.410.126	153.227
c. Me tre ose më shumë kate	51	360.782	11.705.111	17.898
d. Rezidenca për komunitetet	6	26.067	759.617	136.507
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	76	105.448	4.329.729	701.152
a. Hotele dhe të ngjashme	8	25.372	1.072.749	38.921
b. Ndërtesa për zyra	5	9.874	649.038	314.979
c. Ndërtesa tregtare	8	10.356	299.775	34.097
d. Ndërtesa industriale	34	44.135	1.416.567	128.764
e. Ndërtesa të tjera	21	15.711	891.600	184.391
II. Punime inxhinierike			2.060.596	6.771.216
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			1.509.726	2.845.078
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			543.593	3.134.537
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			7.277	791.601

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 19	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20
Shqipëria	202	184	209	262	306
Berat	1	4	10	16	14
Dibër	3	2	11	3	6
Durrës	23	12	27	49	39
Elbasan	23	19	24	27	39
Fier	23	15	19	32	35
Gjirokastrë	1	4	9	5	2
Korçë	24	16	14	15	18
Kukës	0	1	0	10	16
Lezhë	15	8	12	15	16
Shkodër	16	3	18	8	6
Tiranë	66	84	63	68	98
Vlorë	7	16	2	14	17

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 19	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20
Shqipëria	241.708	333.645	322.294	397.947	554.325
Berat	98	657	2.868	5.193	6.589
Dibër	557	260	4.250	1.470	580
Durrës	19.422	8.971	12.468	72.467	56.801
Elbasan	5.725	6.047	10.004	36.053	9.945
Fier	8.129	7.257	6.735	22.160	18.957
Gjirokastër	134	4.453	1.576	644	4.092
Korçë	10.759	8.112	4.689	4.020	6.335
Kukës	0	115	0	14.795	7.707
Lezhë	32.025	1.923	6.536	9.719	31.440
Shkodër	3.075	292	8.185	3.016	13.714
Tiranë	148.121	282.916	264.387	210.934	363.485
Vlorë	13.663	12.642	596	17.476	34.680

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	IV - 19	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20
Shqipëria	11.744.012	13.375.967	14.835.465	19.524.524	28.868.337
Berat	224.810	116.140	913.810	421.874	1.218.252
Dibër	159.184	12.669	533.248	151.720	54.504
Durrës	602.812	247.348	1.091.556	3.187.160	2.358.751
Elbasan	354.759	836.582	879.350	2.071.218	465.750
Fier	1.403.325	625.026	584.484	1.365.450	4.133.311
Gjirokastër	17.896	144.851	44.227	346.723	731.371
Korçë	483.100	461.097	156.079	1.035.576	836.370
Kukës	0	3.122	0	483.829	711.818
Lezhë	964.939	590.569	172.240	795.732	2.399.418
Shkodër	895.028	32.378	322.504	226.538	512.780
Tiranë	5.640.583	9.709.233	8.891.035	8.244.681	13.100.938
Vlorë	997.576	596.952	1.246.932	1.194.023	2.345.074

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstrukcioneve.

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.